



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2021

**VENDIM**  
**Nr. 579, datë 07.12.2021**

**PËR**  
**CAKTIMIN E GJYQTARIT TË SKEMËS SË DELEGIMIT**  
**Z. FLORJAN KALAJA, PËR GJYKIMIN E NJË ÇËSHTJEJE GJYQËSORE**  
**NË GJYKATËN E POSAÇME TË APELIT PËR KORRUPSIONIN**  
**DHE KRIMIN E ORGANIZUAR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në shkronjën “a”, të pikës 4 dhe pikën 7, të nenit 45, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 13, të Vendimit të tij nr. 22, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, pas shqyrtimit të kërkesës së Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, dërguar me Shkresën nr.500 prot., datë 02.12.2021, protokolluar në Këshill me aktin nr.5524 prot., datë 03.12.2021, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe mbas shortit të hedhur,

**VENDOSI:**

1. Gjyqtari i skemës së delegimit z. Florjan Kalaja caktohet për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar çështjen penale me të pandehur: {...}, etj.; Akuza: “Për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 259-25, 188/2-25, 188/2, 245/1-25, 244 të Kodit Penal”.
2. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit Florjan Kalaja, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**